



Nr. _____ prot.

Tiranë, më 25.04.2019

**Lënda : REALIZIMI I TREGUESVE EKONOMIKO FINANCIARË
GJATE TTREMUJORIT TE PARE TË VITIT 2019**

**Drejtuar : Z.Thoma GËLLÇI
DREJTORI I PËRGJITHSHËM RTSH
BORDIT TE ADMINISTRIMIT RTSH**

Realizimi i treguesve të mësipërm analizohet duke u bazuar në Vendimin nr.1 datë 15 Shkurt 2019, mbi miratimin e buxhetit të RTSH për vitin 2019.

**I.Realizimi i të ardhurave në krahasim me planifikimin gjatë 3/Mujorit të parë të vitit
2019**

Në 000/lekë

TE ARDHURAT	Plani Buxhetit Viti 2019	Plani 3/Muj.Pare Viti 2019	Realizimi 3/mujori pare 2019
I Financimi nga buxheti	615,000	211,406	211,406
Bashkatdhetarët&Sateliti	240,000	90,800	90,800
Projekte Filmike&Artistike	65,000		
Orkestra Simfonike RTSH	60,000	19,200	19,200
Shërbim mirëmbajtje rrjeti digjitaliz.,etj	200,000	80,000	80,000
Investime në Teknologji	50,000	21,406	21,406
II.Të ardhura nga tarifa aparatit televiziv	1,400,000	350,000	311,656
III.Të ardhura te institucionit	375,000	69,000	50,775
Sherbim ambjentet transmetuese, tr.fm	147,000	40,000	24,348
Reklama,njoftime etj.	95,000	15,000	9,627
Të ardhura të tjera	57,000	14,000	16,800
Të ardhura Kontrata me Kinën	76,000		
TOTALI I+II	2,390,000	630,406	573,837

***Të ardhurat janë realizuar në masën 91% në krahasim me planifikimin .
Mungesat në vlerën absolute 56,569 mijë lekë analizohen në vijim :
1-Të ardhurat nga buxheti janë realizuar në masen 100%.***





Për të gjithë zërat e financimit parashikohet realizimi 100% i shpenzimeve deri në fund të vitit. Zëri i projekteve filmike e artistike parashikohet të fillojë të përdoret në muajin maj 2019. Zëri i Investimeve është përdorur për likuidim pjesor të investimit RTSH Agro, diferenca mbetet për të kryer investime të parashikuara të vitit 2019.

2.E ardhura nga tarifa e aparatit tv.

Tarifa aparatit televiziv është realizuar në masën 89% në krahasim me planin vjetor. Në fakt bazuar në planin vjetor të kësaj tarife, arkëtimi duhet të jetë në kufijtë e mbi 117,000,000 lekë, pasi nëse arkëtimi vazhdon në këtë nivel, atëherë ekziston risku i mosrealizimit të planit, duke krijuar vështirësi në gjendjen financiare të Rtsh-së. Gjatë periudhës tremujore vlerat e arkëtitimit të kësaj tarife ishin 110,108,173 lekë në janar, 103,601,825 lekë në shkurt dhe 97,945,587 lekë në mars, duke krijuar në total një mungesë në vlerë absolute **38,344 mijë leke** krahasuar me planin tremujor. Nëse arkëtimi vijon në këtë trend, vlera e munguar në buxhetin e viti 2019 parashikohet ~ 150 milion lekë. Ka vijuar arkëtimi me vonesë të tarifës, duke mbartur detyrimet e RTSh-së ndaj punonjesve dhe të tregëve në fillim të muajit pasardhës.

3.Të ardhurat e realizuara nga vetë RTSH

a.Të ardhurat nga shërbimi në ambientet transmetuese të RTSH dhe transmetime fm janë realizuar në masën ~60% ose me një mungesë në vlerë absolute **15,652 mijë lekë**. Realizimi në këtë nivel vjen si rezultat i faturimit bazuar në kontratat ekzistuese të RTSh-së, si rezultat i shtyrjes së afatit të transmetimeve analoge në muajin shtator 2019.

Risku i realizimit të këtij zëri në kufijte e planifikimit vijon të qëndrojë i lartë në kushtet aktuale.

b.Në zërin e reklamave, njoftimeve etj, gjatë kësaj periudhe ka një realizim në masën 64%, ose një mungesë në vlerë **5,373 mijë leke**.

Risku i realizimit të të ardhurave të këtij zëri në kufijte e planifikimit vazhdon të qëndrojë i lartë. Ecuria e realizimit të këtij zëri pritet të jetë në kufijtë e planifikimit pas gjashtëmujorit të parë e në vijim, pasi kjo periudhe përkon me fushatën zgjedhore, e në periudha të tilla të ardhurat nga reklama janë paraqitur me vlera të ulëta realizimi.

c.Në zërin e të ardhurave të tjera janë realizuar të ardhurat e parashikuara në nivelin 120%. Në këtë zë janë përfshirë të ardhurat nga klikimet e kanaleve të RTSH në youtube, shitja mat.arkivore, të ardhura nga kontratat e qerasë së lokalit, pajisjeve dhe studiove, nga rimbursimi i shpenzimeve të radiostacionit të Cerrikut, kontrata e shitjes së materialit skrap etj. Realizimi i këtij zëri parashikohet të jetë edhe në vijim në nivelin e planifikuar, nisur edhe nga ecuria e viteve të tjera.

Gjatë vitit 2019 janë ndjekur hap pas hapi edhe detyrimet e të tretëve ndaj RTSH-së.

a) Me nisjen e shkresave për likuidim detyrimi reklama, njoftime etj., si edhe njoftimet për ndjekjen në rrugë gjyqësore u bë i mundur arkëtimi i detyrimeve të vitit 2018 në vlerën ~ 5,800,000 lekë nga subjektet Economic Social Analytics, Tring Sha, Ogilvy, Eurosig, Impact sha, Landmark Communications dhe pjesërisht subjekti Gogel. Subjekti Gogel paraqet një vlerë detyrimi të lartë ~ 6,800,000 lekë dhe po ndiqet nga Drejtoria e Marketingut, pasi ka kontrate në vijim gjatë vitit 2019.

Ndërkohë kanë nisur procedurat gjyqësore për subjektet Top Albania në vlerën 479,728 lekë dhe Gener 2 në vlerën 1,062,880 lekë.

b) Nga njësia Teknike gjithashtu janë dërguar në Drejtorinë Juridike për ndjekje në rrugë gjyqësore detyrimet e subjekteve MRM, Channel one, Ora News, 4+ Mediagroup, Teknomedia në vlerën ~ 5 milion lekë.





Të ardhurat e pritshme të arkëtohen në cash, nisur edhe nga pasqyra tremujore e të ardhurave realizuar në vitin 2019 qëndrojnë në vlerën ~ 25 milionë lekë.

-Krahasimi i të ardhurave të realizuara gjatë periudhës tremujore të katër viteve të fundit, duke zbritur vlerat e të ardhurave të trashëguara nga vitet parardhëse:

ne 000/leke

TE ARDHURAT	Realizimi 3/mujori pare 2016	Realizimi 3/mujori pare 2017	Realizimi 3/mujori pare 2018	Realizimi 3/mujori pare 2019
I Financimi nga buxheti	75,000	108,200	245,481	211,406
Bashkatdhetarët&Sateliti	60,000	56,000	43,200	90,800
Projekte Filmike&Artistike				
Orkestra Simfonike RTSH	15,000	14,000	10,800	19,200
Shërbim mirëmbajtje rrjeti digj. etj.		38,200	191,481	80,000
Investime ne Teknologji				21,406
II.Të ardhura nga taksa aparatit televiziv	383,106	294,300	302,407	311,656
III.Të ardhura të Institucionit	46,235	39,180	44,819	50,775
Sherbim ne ambiente te transmetuese	29,825	18,480	20,064	24,348
Reklama,njoftime etj.	11,410	15,400	18,715	9,627
Te ardhura te tjera	5,000	5,300	5,040	16,800
Te ardhura Kontrata me Kinen				
TOTALI I+II	504,341	441,680	592,707	573,837

II.Realizimi i shpenzimeve në krahasim me planifikimin gjatë 3/mujorit të paë 2019

ne 000/leke

Nr	Emertimi	Planifikimi Viti 2019	Planifikim i 3/muj.I Viti 2019	Realizimi 3/muj.I Viti 2019
1	Paga,shpërblime ,sig.shoqeror	801,150	200,000	193,736
2	Materiale,lende djegese	66,500	17,680	17,401
3	Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav. etj	317,000	97,767	93,151
4	Organizma Nderkombetar	87,000	18,600	15,518
5	Shërbime nga të tretë	235,050	46,096	39,007
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	86,500	13,329	10,238
7	Shpenzime të tjera operative	71,800	17,823	14,340
8	Investime dhe miremb. rrjeti digj.	395,000	119,500	106,655





9	Shpenz.këste e interesa kredie	330,000	170,000	272
	TOTALI	2,390,000	700,795	490,318

Nga të dhenat e mësipërme shpenzimet janë realizuar në masën 70%, ose 92% duke zbritur nga planifikimi vlerën e kredise, e cila nuk mund të likuideohej nga RTSH si rezultat i mungesës së të ardhurave ,relatuar vazhdimisht në Ministrinë e Financave.

Në mënyrë analitike realizimi i cdo zëri paraqitet si vijon :

***Zëri Paga, sigurime shoqërore e shpërblime** është realizuar në masën 97% .Cdo ndryshim strukturor është duke u ndjekur paraprakisht edhe me efektin në vlerë që do të sjellë në fondin e pagave. Në total fondi i pagave , sig.shoqërore e mbikohës është brenda planit.

Aktualisht risku i këtij zëri qëndron në ndryshimet strukturale, të cilat kërkojnë shtesa vlerash fondesh, ndërsa mundësitë e realizimit të të ardhurave qëndrojnë në kufij të limituar.

***Zëri Materiale** përfshin shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore teknike, materiale ndihmëse dhe lëndë djegëse(karburant). Realizimi i këtij zëri është në masën 98%, i pritshëm të realizohet në total në periudhën në vijim.

***Zëri i projekteve Filmike dhe Artistike dhe blerjet e te rejtave tv e te transmetimit** , përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit, dokumentarë, filma, programe sportive, artistike, shpenzimet për projektet e miratuara. Realizimi në total i këtij zëri është në masën ~95.

Mosrealizimi vjen kryesisht nga vlera e fondit të prodhimit të pavarur paperdorur gjatë kesaj periudhe.

***Zëri i Organizmave Ndërkombëtare** përfshin të gjitha shpenzimet që RTSH kryen ndaj organizmave ndërkombëtare, si Eutelsat, Ses Astra, për shërbimin satelitor, EBU për pagesat për transmetime në radio, televizion, lajme, të drejta transmetimi të programeve e aktiviteteve të ndryshme artistike dhe sportive dhe pagesat e pjesëmarrjes. Realizimi i këtij zëri gjatë kesaj periudhe është në masën 70%.

*** Zëri i Shërbimeve nga të tretë** përfshin shpenzimet për shërbime të një natyre të përgjithshme që kryhen nga të tretet për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së RTSH, si shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzimet telefonike, shpenzimet për ruajtjen e sigurisë fizike të objekteve të RTSH, qera të ambjenteve,etj. Realizimi i këtij zëri është në nivelin 85% , i pritshëm për tu realizuar 100% sipas planifikimit deri në fund të vitit , pasi edhe shpenzime të larta parashikohen gjatë periudhës në vijim.

***Zëri i shpenzimeve Udhëtim e dieta** është realizuar pothuaj në nivelin 78%, brenda kufijve të planifikimit në të gjitha drejtoritë e njesitë e sistemit, i pritshëm të ketë tendence rritje gjatë tremujorit të dytë, por duke u mbajtur brenda kufijve të planifikimit.

***Zëri i shpenzimeve të tjera Operative** është realizuar në nivelin 81%. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për pritje e percjellje në Drejtorinë e Përgjithshme, shpenzimet për honorare në të gjitha drejtoritë e sistemit si edhe shpenzimet për taksa,tatime etj.

***Zëri i shpenzimeve për Investime dhe shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit** është realizuar në nivelin 95%.

Gjatë kesaj periudhe janë kryer pagesat për shpenzime të mirëmbajtjes së rrjetit për periudhën shtator-dhjetor 2018, dhe vetëm pjesërisht kontrata e investimit RTSH Agro në vlerën 21 milionë lekë si edhe diferenca të vogla të procedurave të investimeve, mbikqyrje punimesh dhe përqindje të kontratave të rikonstruksionit .





***Zëri i shpenzimeve për keste e interesa kredie.** Gjatë kësaj periudhe janë likuiduar kuota të kontratës së huasë , ndërsa si rezultat i mungesës së të ardhurave në momentin e pagesës së kredisë , pagesa e planifikuar në muajin mars 2019 u krye nga Ministria e Financave si garantues i kredisë.

Krahasimi i Shpenzimeve të RTSH gjatë tre viteve të fundit

Ne 000/leke

Nr	Emertimi	Realizimi 3/muj.I Viti 2016	Realizimi 3/muj.I Viti 2017	Realizimi 3/muj.I Viti 2018	Realizimi 3/muj.I Viti 2019
1	Paga,shperblime ,sig.shoqeror	194,158	195,416	190,213	193,736
2	Materiale,lende djegese	10,740	9,371	10,869	17,401
3	Projekte filmike,artistike,etj	49,409	54,024	108,846	93,151
4	Organizma Nderkombetare	52,519	36,169	22,404	15,518
5	Sherbime nga te trete	63,687	60,345	63,283	39,007
6	Shpenzime udhetime e dieta	15,209	14,703	14,461	10,238
7	Shpenzime te tjera operative	7,791	9,937	14,445	14,340
8	Investime dhe Mirambajtje rrjeti digjitalizimi	112,586	87,304	66,046	106,655
9	Shpenzime kest e interesa kredie			166,889	272
	TOTALI	506,099	467,269	657,456	490,318

Niveli i shpenzimeve gjatë këtij tremujori, i diktuar nga ecuria e të ardhurave paraqitet pothuaj në të njëjtin nivel me tremujorin e vitit të kaluar, po të zbrisim këtu pagesën e kryer gjatë vitit 2018 të kështit të kredisë.

Në mënyrë të përmbledhur , duke analizuar situatën e deritanishme të të ardhurave dhe shpenzimeve , risku i realizimit të buxhetit të RTSh gjatë këtij viti paraqitet i lartë.

Në këto kushte, ashtu sikurse gjatë tremujorit të parë, edhe gjatë periudhës në vijim do të vazhdojë të ndiqet hap pas hapi ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve. Krahas limitimit të shpenzimeve është ndjekur edhe praktika e likuidimit të tyre kryesisht në fund të muajit, përjashtuar këtu shpenzimet që kanë patur afate të përcaktuara. Kjo si rezultat i problematikës së arkëtimit të tarifës në muajin pasardhës , si edhe i të ardhurave të tjera që në tremujorin e parë të cdo viti paraqiten më të ulëta.

Duke u nisur thjesht nga një mesatare e buxhetit të miratuar të RTSH-së, të ardhurat duhet të jenë në vlerën mesatare ~200 milion lekë/ muaj.

Nga analiza tremujore , parashikimi për periudhën në vijim, bazuar në nivelin aktual të të ardhurave, sikur të arketohen në nivelin 100% brenda muajit ,RTSH paraqitet në këtë situatë:

-Të ardhura mujore në vlerën ~150 milion lekë.(në muajt qershor ka një shtesë 550,000 usd kontrata me Kinen dhe në muajin nëntor ~100,000 Euro Eutelsat)

-Shpenzimet në nivelin mujor llogariten në minimumin ~150 milion lekë (dhe 170 milion në muaj të vecante për të drejta tv e kuotizacione).

Në këto kushte cdo mungesë e arkëtimit në nivelin e e planifikuar krijon detyrime të mbartura nga njue muaj në tjetrin.

